

Standardi puro Serb me titull ***“Rregullore mbi mënyrën e verifikimit gjatë testimit, markimit, testimit individual ose homologimit, kontrollit të llojit të municionit, testimit e armëve të zjarrit të çaktivizuara dhe armëve të zjarrit qëllimi i të cilave është ndryshuar në mënyrë të përhershme për përdorim civil, si dhe shfaqjen e shenjësve dhe shenjave të provës”***.

Ky standard **18 faqësh**, specifikon mënyrën e kryerjes së kontrolleve gjatë testimit, vulosjes dhe shenjimit të armëve, pajisjeve dhe municioneve, llojet e provave, llojet e kontrolleve, dimensionet e përgjithshme të sigurisë, miratimin e llojit të armëve, pajisjeve dhe municioneve dhe vulosjen e tyre.

Në objektin është harmonizimi i legjislacionit, në përmbushje të një prej kushteve themelore për aderimin e Republikës së Serbisë në Konventën për Njohjen e Ndërsjelltë të Markave të Armëve të Vogla.

Afati i fundit për marrjen e komenteve është **30-01-2020**.

Ky njoftim realizohet në kuadër të njoftimit të operatorëve ekonomikë që mund të kenë interesa tregtare me shtetin serb lidhur me këtë kategori produktesh, të cilët mund të paraqesin komentet e tyre. Komentet potenciale adresohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit, e cila me ligj është pika e kontaktit për sa i përket shkëmbimit të informacionit mbi standardet dhe rregullat teknike.